

#INNO4EDU

Titulli i aktivitetit	
Instrumente muzikore	
Mosha	
Periudha zhvillimore (nga 3 deri në 10 vjet)	
Vendi / lokacioni	Vlera e karakterit
Kushte shtëpie	Kreativitet
Koha e nevojshme për përgatitje	Koha e nevojshme për realizim
20 minuta	30 minuta
Qëllimet	
Qëllimi është që fëmija të aftësohet për shfrytëzimin e sendeve dhe mjeteve të ndryshme për shprehjen e ideve të veta dhe të përftojë ndjeshmëri për njohjen e tingujve të këndshëm e të pakëndshëm.	
Rezultate të pritshme	
Kahje	
<u>Përgatitje paraprake për aktivitet</u> Përgatitje e materialeve për lojë në tryezë.	
<u>Instrukcione / kahje për lojën</u> Nga të gjitha materialet e vendosura fëmijës i propozohen ide të caktuara çfarë instrumentesh mund të prodhohen dhe në farë mënyre ato do të prodhojnë tingull. Përpiquni të krijoni sipas ideve tuaja dhe të fëmijës, mund të shpiken edhe vegla të reja për të qenë më dëfryese.	



Për shembull:

Rropatëse

- Gota plastike / kavanozë të mbushur me groshë / oriz / kripë/ miell e të ngjashme. Sipër vendoset një letër për pjekje dhe mbyllet me llastik, kurse kavanozi mbyllet me kapak.
- Tullumbace që mbushet me thjerëza, e pastaj fryhet dhe lidhet.
- Kuti plastike (nga salca e kosit) si daulle dhe ngjyra druri si shufra për rropatje e të ngjashme.

Instrumente me tela

- Nga kutia plastike (nga salca e kosit) hiqet kapaku dhe në mes të sajin tërheqim llastikë si tela kitare.
- Nga pjesa e brendshme e letrës së tualetit ose letrës së kuzhinës (cilindri) bëhet një hapje qarkore. Në cepat e cilindrit vendosen llastikë si tela instrumenti dhe lidhen me kapëse.

Instrumente frymore

- Një gyp futet në qese për ngrirje e cila fryhet dhe lidhet në grykë. Me fryerje në gyp prodhohet tingull.
- Disa gypa bashkohen me selotejp
- Bashkohen 2 – 3 rula kartoni (nga letra tualeti ose letra kuzhine) si bori

Instrumente me tastierë

- Në një kuti vizatohen tastet e pianos

Aktivitet / lojë

Me fëmijën bisedohet për llojet e instrumenteve: me tela, frymore, me goditje dhe instrumente me tastierë. Teksa bisedohet për instrumentet duhet fëmijës t'i tregohen si fotografi dhe të lëshohen tinguj prej tyre (mund të gjendet vegëz në internet). Pastaj, sipas materialeve për punë, dëshirës dhe interesit të fëmijës prodhohen instrumentet muzikore dhe të gjithë anëtarët e familjes bashkërisht kompozojnë / sajojnë "Këngë të ditës" me instrumentet që i kanë bërë.

Shtojca	Materiale
<p><u>Shtojca nr. 1</u></p> <p>Kuiz për instrumente muzikore</p> <p>https://www.youtube.com/ëatch?v=ËV63aVMnyMA</p>	<p>CD plejer; gota plastike; letër për pjekje; qese për ngrirje; kavanoz i vogël; kuti plastike (nga salca e kosit); pipëza; groshë; oriz; thjerza; kripë; llastikë; selotejp; letër tualeti (cilindrat); kapëse; gërshtë; tullumbace; ngjyra; kuti; ngjitës;</p>

Aktiviteti është përgatitur nga edukatorët:	
Krijuar nga: Sonja Çallovska, Vesna Peceva Dizajni grafik: Katerina Nikolovska	

